



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE \* MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA \* SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 3, al. 1, pika “b” të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45 të dt. 11 gusht 2000 dhe nenit 19, al. 3, pika “b”, të Statutit dhe rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës në mbledhjen e mbajtur më 31.10.2003 merr

**V E N D I M**  
**MBI QASJEN E HARTIMIT TË PLANIT RREGULLATIV TË KOMPLEKSIT**  
**TË QENDRËS “FUSHA E PAJTIMIT” NË LAGJEN “GALLAPI” NË**  
**PRISHTINË**

Neni 1

Miratohet Vendimi mbi qasjen e hartimit të Planit rregullativ të Kompleksit të qendrës “Fusha e Pajtitimit” në lagjen “Gallapi” në Prishtinë.

Neni 2

Me Planin rregullativ nga neni 1 i këtij Vendimi, do të rregullohet hapësira e përfshirë në ngastrat kadastrale nr. 722, 423, 724, 725, 726, 727, 830, 831, 832, 833, 834, 835 Komuna Kadastrale Prishtinë, në sipërfaqe të tërësishme prej 13.39.30 ha

Neni 3

Kompleksi, nga neni 2 i këtij Vendimi, shpallet zonë me interes për Komunën e Prishtinës.

Neni 4

Qëllimi i qasjes për hartimin e Planit rregullativ nga neni 1 i këtij Vendimi, është rregullimi i hapësirës nga neni 2 i këtij Vendimi, si dhe ndërtimi i objekteve për nevojat e interesit të përgjithshëm shoqëror, sipas përmbajtjeve të përcaktuara me programin projektues.

Neni 5.

Hartimi i Projektplanit rregullativ nga neni 1 i këtij Vendimi, do të bëhet nga Drejtorati për Planifikim, Urbanizm dhe Ndërtimtari.

#### Neni 6

Mjetet për përgatitjen e hartimit të Projektplanit rregullativ sipas këtij Vendimi, do t'i sigurojë Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

#### Neni 7

Për realizimin e këtij Vendimi do të kujdesen Bordi i drejtorëve dhe Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe Ndërtimtarisë i Komunës së Prishtinës.

Drejtorati i Kadastërit dhe Gjeodezisë dhe Drejtorati i Financave dhe Pronësisë i Komunës së Prishtinës, do të kryejnë veprime procedurale nga përgjegjësia e tyre, e caktuar për realizimin e këtij Vendimi.

#### Neni 8

Në ditën e miratimit të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi mbi caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për nevojat e "Qendrës Kulturore" në Prishtinë nr. 01-353-1504 dt. 30.07.2002.

#### Neni 9

Ky Vendim hyn në fuqi dhe aplikohet ditën e miratimit të tij nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
**01.NR.353-1921.DT.06.11.2003**

**KRYETARI I KUVENDIT**  
**Ismet Beqiri**